

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Do t'i godasim fort", pas kërcënimeve të Trump për Iranin, rritet çmimi i naftës në bursë – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/do-ti-godasim-fort-pas-kercenimeve-te-trump-per-iranin-rritet-cmimi-i-naftes-ne-burse/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 23:34:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	1 shtator 2026, 07:12:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	498c2900ffd58c9f96185cea2d8a5cda16e92e23fe6fa37837b918545c32f2dd
TEKSTI	e316aa85ecd4a3f84e30fd996fa627249f2dbf99bc938a8e3b6676fde6c56c0d
PAMJA	ecf81cc02bfff3edd5da0bce508f9227c03291c922751a8ee9998d404e019bdbb8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	11d497fd9da61fba1fa1a832a7129f9ead1ca32eeaf27fd262006ee7391ade92
E MËPARSHMJA	c05cdbcc8860e5f9e2b7a663b053036ccced51f6d7362f43aab0864c9d00ba3c
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/11d497fd9da61fba1fa1a832a7129f9ead1ca32eeaf27fd262006ee7391ade92>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SHBA-ja dhe Irani kanë shkëmbyer sulme ushtarake për herë të parë në më shumë se një muaj, në një përshkallëzim që rrezikon të rikthejë konfliktin në Lindjen e Mesme pas disa javësh qetësie relative.

Ushtria amerikane goditi dy raketahedhës iranianë në ishullin Larak, pasi, sipas Komandës Qendrore të SHBA-së (CENTCOM), forcat iraniane po përgatiteshin të vendosnin mina detare në Ngushticën e Hormuzit, një prej rrugëve më të rëndësishme të transportit të naftës në botë.

Irani u kundërpërgjigj duke lëshuar raketa drejt objektivave ushtarake amerikane në Jordani dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Jordania deklaroi se sistemet e saj të mbrojtjes ajrore rrëzuan tetë raketa që hynë në hapësirën ajrore të vendit.

Trump paralajmëron: “Do t’i godasim fort”

Presidenti amerikan Donald Trump e cilësoi sërish Iranin si një “shtet të dështuar” dhe deklaroi se Uashingtoni do të reagojë ndaj sulmeve iraniane.

Përshkallëzimi i fundit ka ndikuar menjëherë edhe në tregjet energjetike. Çmimet globale të naftës u rritën me gati 3%, për shkak të shqetësimeve për sigurinë e lundrimit në Ngushticën e Hormuzit.

Ngushtica është kthyer në qendër të përplasjes mes dy vendeve. SHBA-ja pretendon se po garanton lëvizjen e lirë të anijeve, ndërsa Irani e ka lidhur hapjen dhe sigurinë e korridorit detar me zhvillimet më të gjera politike dhe të sigurisë në rajon.

5 Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor:
Besoni te vetja dhe tek ëndrrat,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Negociatat mbeten të bllokuara

Përplasja e fundit vjen në një moment kur negociatat direkte mes Uashingtonit dhe Teheranit mbeten të bllokuara. Shtëpia e Bardhë deklaroi ditët e fundit se aktualisht nuk ka negociata në zhvillim.

Megjithatë, Irani dhe Omani vijnë diskutimet për një marrëveshje që do të mundësonte rikthimin e trafikut normal detar përmes Ngushticës së Hormuzit. Vende të tjera të rajonit, përfshirë Katarin, kanë mbështetur përpjekjet diplomatike.

Këshilltari i presidentit të Emirateve, Anwar Gargash, paralajmëroi se gjendja aktuale e "as luftë, as paqe" nuk mund të jetë një zgjidhje e qëndrueshme dhe bëri thirrje për një zgjidhje politike dhe ekonomike të krizës.

Ndërkohë, administrata Trump po shton edhe presionin ekonomik ndaj Teheranit. Sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, tha se SHBA-ja pritet të vendosë sanksione të reja dytësore ndaj Iranit çdo javë, duke nisur me sektorin bankar.

Përplasja e fundit shënon kështu rikthimin e drejtpërdrejtë të sulmeve SHBA-Iran, ndërsa frika kryesore tashmë lidhet me mundësinë e një përshkallëzimi të ri ushtarak dhe pasojat që ai mund të ketë për sigurinë e rajonit dhe furnizimin global me energji.

#nafte

#trump



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Trump i kërkon Zelenskyt të...

Xhuljana Zhuleku 37 minuta më parë



BOTA

Tragjedi! Përmbysset anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku Dje 23:17



BOTA

Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...

Xhuljana Zhuleku Dje 19:36



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale